

VENDIM
Nr. 33, datë 14.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Blerina Basha, në datat 7.11.2022 dhe 10.11.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 6 (E) 2022 akti, që u përket:

KËRKUES: Erjon Kusi, Makbule Dragoni, Admir Dragoni, përfaqësuar nga Erjon Kusi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Abaz Deda dhe Valbona Legisi, me autorizim.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-188, datë 10.2.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, pika 2, 17, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “F”, 132, pika 1 dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 53 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, përfaqësuesin e kërkuësve, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, shqyrtoi prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Bashkia Tiranë, bazuar në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me vendimet nr. 1028, datë 30.12.1994 dhe nr. 148, datë 30.9.1997, i ka njohur trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Haxhi Shtëpaza të drejtën e pronësisë mbi një truall me sipërfaqe 23.552 m², i ka kthyer trojet me sipërfaqe 3.912 m² dhe 518 m², i ka njohur të drejtën e kompensimit për truallin me

sipërfaqe 18.305 m², si dhe të drejtën e parablerjes mbi objektet shtetërore të ndodhura në pronën e tij në kohën e privatizimit.

2. Në zbatim të së drejtës së kompensimit për truallin e zënë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 103, datë 30.4.2015, ka vendosur kompensimin financiar vetëm për 200 m² truall në vlerën 6.011.800 lekë.

3. Në datën 30.5.2016 ATP-ja, e cila ka zëvendësuar AKKP-në, në zbatim të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*), ka rishikuar vendimet e mësipërme të KKKP-së, Tiranë për kthimin dhe kompensimin e pronës, duke rivlerësuar në tërësi pasurinë e shpronësuar. Ajo e ka klasifikuar pasurinë në zërin kadastral “tokë bujqësore”, duke iu referuar kohës së shpronësimit dhe ka arritur në përfundimin se vlera e pronës së kthyer e tejkalonte vlerën e pronës së njohur për kompensim. Për rrjedhojë, ATP-ja ka urdhëruar publikimin e vlerësimit përfundimtar me shënimin “ezauruar”.

4. Një prej trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, duke mos qenë dakord me rivlerësimin financiar të ATP-së, ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 15 (86-2017-1629), datë 18.4.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se vlerësimi financiar i kryer nga ATP-ja ishte i saktë, pasi në vitin 1993 kjo pronë ishte klasifikuar në zërin kadastral të origjinës si “tokë bujqësore”.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-188, datë 10.2.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të trashëgimtarit të subjektit të shpronësuar, me arsyetimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte i bazuar në ligj. Gjykata e Lartë ka evidentuar se në vendimin e rekursuar ishte i drejtë konstatimi se ligji i kohës e përcaktonte zërin kadastral të tokës truall ose bujqësore, pa e lidhur domosdoshmërisht me vendndodhjen e saj në raport me vijën kufizuese të qytetit.

6. Në datën 9.6.2022, duke qenë se trashëgimtari i subjektit të shpronësuar, që kishte vënë në lëvizje gjykimin e zakonshëm, kishte ndërruar jetë më 16.11.2020, trashëgimtarët ligjorë të tij (*kërkuessit*) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

7. Kolegji i Gjykatës në datën 26.7.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. Kërkuessit kanë pretenduar në mënyrë të përmbledhur se iu është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi ndonëse prona e tyre nuk duhej të rivlerësohej më, ajo është vlerësuar në vitin 2015 në zërin kadastral “*truall*” për shkak të kompensimit financiar të sipërfaqes prej 200 m², ndërsa në rivlerësimin e vitit 2016 është klasifikuar në zërin kadastral “*tokë bujqësore*”. Gjykata Administrative e Apelit, me të njëjtët gjyqtarë, ka ndjekur dy standarde të ndryshme për pjesën tjetër të së njëjtës pasuri të të njëjtit subjekt të shpronësuar dhe që ndodhej në të njëjtin vend, duke e ndryshuar zërin kadastral nga “*tokë bujqësore*” në “*tokë truall*”.

8.1.2 *Parimit të barazisë së armëve*, pasi pavarësisht provave të mjaftueshme të kërkuessve, Gjykata Administrative e Apelit ka konsideruar vetëm prapësimet e ATP-së, duke e bërë të pamundur mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme.

8.1.3 *Së drejtës së aksesit*, pasi ATP-ja në një datë të pacaktuar dhe pa një akt konkret ka bërë rivlerësimin e zërit kadastral pa asnjë provë dhe në kundërshtim me ligjin. Ajo nuk ka vënë në dispozicion të kërkuësve informacionin për zërin kadastral të zonës.

8.2 *E drejta e ankimit*, e garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, pasi sipas ligjit nr. 133/2015 vendimet e ATP-së ankimohen në shkallë të parë në Gjykatën Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë, si gjykatë e shkallës së dytë, nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, që ishte e nevojshme në rastin e kërkuësve.

8.3 *E drejta e pronës* në drejtim të mosrespektimit të *parimit të proporcionalitetit*, sipas nenit 17 të Kushtetutës, pasi vendimi për të konsideruar të ezauruar kompensimin financiar për pronën objekt gjykimi bie ndesh me çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendim i datës 17.3.2020, ku Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e ka konsideruar minimumin e vlerësimit të pasurisë në masën 10% të arsyeshëm.

9. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

9.1 Kërkuësit *nuk legjitimohen*, pasi nuk kanë parashtruar natyrën kushtetuese të shkaqeve dhe shkeljeve të kryera nga gjykatat. Në thelb, ata kundërshtojnë vlerësimin financiar të ATP-së, që është shqyrtuar nga gjykatat duke analizuar provat dhe ligjin. Pretendimi se vlerësimi financiar bie në kundërshtim me pikën 12 të nenit 5 të ligjit nr. 133/2015 i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata është shprehur duke arsyetuar edhe vendimmarrjen.

9.2 Pretendimet që lidhen me *procesin e rregullt ligjor* janë me natyrë abuzive dhe nuk duhet të pranohen, për sa kohë që gjykatat e kanë zhvilluar procesin sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Kërkuësit nuk janë konkretë në pretendimet e tyre dhe nuk tregojnë se cili është momenti procedural që gjykata ka keqpërdorur ose çfarë prove e paraqitur nga ana e tyre është refuzuar të administrohet gjatë gjykimin në apelin administrativ.

9.3 Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës* dhe *parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara. Ato janë në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme kushtetuese dhe atë evropiane që ka trajtuar çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri. Shpërblimi i subjekteve të shpronësuara nuk mund të jetë i plotë, por duhet të jetë i drejtë. Skema e kompensimit, e parashikuar nga ligji nr. 133/2015, është konfirmuar edhe nga GJEDNJ-ja dhe i vetmi korrigjim lidhet me miratimin e tavanit 10% për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit.

10. Subjekti i interesuar, ATP-ja, në përgjigjen me shkrim drejtuar Avokaturës së Shtetit dhe të paraqitur nga kjo e fundit në gjykimin kushtetues, ka shpjeguar aktet dhe përlllogaritjet e kryera për masën e kompensimit. Ai ka prapësuar se vlerësimi i pronës është kryer në përputhje me procedurat dhe rregullat që kanë qenë në fuqi në momentin e lindjes të së drejtës së padisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Çdo individ, subjekt i së drejtës private, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat

negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në çështjen konkrete Gjykata vlerëson se kërkesit legjitimohen *ratione personae*, pasi janë trashëgimtarë ligjorë të palës ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se ndonëse në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë nuk është parashtruar në mënyrë të shprehur pretendimi për mosrespektimin e minimumit prej 10 % të vlerës së kompensimit, në thelb pretendimet kanë të bëjnë me masën e shpërblimit të drejtë për kompensimin e pronës të marrë padrejtësisht nga shteti. Për rrjedhojë, kërkesit kanë plotësuar edhe kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, pasi me ankimin e tyre kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor që ka vlerësuar pikërisht masën e këtij kompensimi. Kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 10.2.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 9.6.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i takon kriterit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesit kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve, së drejtës së ankimit dhe parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës së pronës private të lidhur me parimin e proporcionalitetit. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike janë paraqitur dy shkaqe: *i pari* lidhet me mospërmbylljen e pritshmërive të tyre nga veprimtaria ndër vite e organeve përgjegjëse në rivlerësimin e pronës së njohur për kompensim; *i dyti* lidhet me vendimmarrjet e ndryshme të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, bazuar në interpretimin e kundërt/ndryshëm të ligjit.

14. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkesit nuk legjitimohen në lidhje me këto pretendime, pasi nuk kanë parashtruar natyrën kushtetuese të shkeljeve të kryera nga gjykatat dhe se, në thelb, ata kundërshtojnë vlerësimin financiar të ATP-së, i cili është shqyrtuar nga gjykatat e zakonshme, duke analizuar drejt provat dhe ligjin e zbatueshëm.

15. Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në procesin administrativ mbështetet në argumentin se ATP-ja ka rivlerësuar zërin kadastral të pronës së njohur për kompensim, pa i dhënë ndonjë informacion paraprak përfutësve të shpërblimit. Mirëpo, kërkesit, në paraqitjen e këtij pretendimi, nuk kanë identifikuar bazën ligjore të shkelur nga ATP-ja. Ndërsa pretendimi për cenimin e barazisë së armëve në gjykim mbështetet në argumentin se Gjykata Administrative e Apelit ka konsideruar vetëm argumentet e ATP-së, megjithatë referuar akteve në dosjen gjyqësore gjykimi në shkallë të dytë është zhvilluar në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, të cilat kanë parashtruar qëndrimet e tyre dhe kanë debatuar mbi provat e shqyrtuara, përfshirë edhe aktin e ekspertimit. Në këtë situatë, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesit nuk kanë parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që të mbështesin pretendimet për cenimin e procesit të rregullt në këto aspekte, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit, kërkesit kanë argumentuar se sipas ligjit nr. 133/2015 vendimet e ATP-së ankimohen në shkallë të parë në Gjykatën Administrative të Apelit, për rrjedhojë Gjykata e Lartë, si gjykatë e shkallës së dytë, nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes së tyre. Gjykata vëren se shkak i këtij pretendimi lidhet me përmbajtjen e nenit 19 të ligjit nr. 133/2015, që parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ATP-së për vlerën e kompensimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykata e ka shqyrtuar edhe më herët këtë dispozitë ligjore në aspektin e së drejtës së ankimit, duke e vlerësuar në përputhje me Kushtetutën. Konkretisht, Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, që parashikohet nga ligji nr. 133/2015, i plotëson kriteret për të pasur një kontroll gjyqësor të akteve të nxjerra nga organe administrative ose kuazi gjyqësore. Shteti nuk ka detyrimin të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë

që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Në këto kushte, kriteri i kontrollit gjyqësor të akteve të pushtetit publik është i garantuar nga ligji nr. 133/2015 (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së ankimit, në mënyrën se si është parashtruar në këtë gjykim, duke u lidhur me përmbajtjen e dispozitës ligjore të ligjit nr. 133/2015, përbën gjë të gjykuar, ndaj nuk mund të merret më në shqyrtim.

17. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të vendimmarrjeve të ndryshme gjyqësore, kërkuesit kanë argumentuar se Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 70 (86-2018-2178), datë 11.5.2018, me të njëjtin trup gjykues, ka pranuar padinë e trashëgimtarëve të të njëjtit subjekt të shpronësuar, Haxhi Shtëpaza, për ndryshimin e zërit kadastral nga “tokë arë” në “tokë truall”, për një pasuri që ndodhet në të njëjtin vend me pasurinë objekt gjykimi, duke krijuar dy standarde të ndryshme të interpretimit të ligjit.

18. Gjykata pohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Gjykata e Lartë i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se vendimi nr. 70 (86-2018-2178), datë 11.5.2018 i Gjykatës Administrative të Apelit, i paraqitur si tregues i arbitraritetit të interpretimit të ligjit në çështjen e kërkuesve, nuk është përfundimtar, por është në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, bazuar në rekursin e paraqitur nga ATP-ja. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të vendimmarrjeve të ndryshme të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, nuk mund të merret në shqyrtim për sa kohë që vendimi i dytë nuk është bërë ende përfundimtar. Po kështu, në funksion të parimit të subsidiaritetit të gjykimit kushtetues dhe kompetencës së Gjykatës së Lartë jo vetëm për kuptimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, por edhe për kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese, i takon asaj gjykate të vlerësojë vendimet e gjykatave të zakonshme edhe në drejtim të uniformitetit të interpretimit e zbatimit të së drejtës, si element i parimit të sigurisë juridike.

20. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, e cila përbën të drejtë kushtetuese me natyrë substanciale, Gjykata thekson se, si rregull, ajo i shqyrton pretendimet e individit për cenimin e të drejtave themelore pas shterimit të shkallëve të zakonshëm të gjykimit, duke qenë se bazuar në parimin e subsidiaritetit gjykatat e zakonshme, në përputhje me kompetencat e tyre, kanë mundësitë të riparojnë shkeljet eventuale, duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, Gjykata, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mund t’i shqyrtojë pretendimet për cenimin e të drejtave themelore substanciale në mënyrë autonome, pra pa i lidhur domosdoshmërisht me procesin e rregullt ligjor, kur shkak përcaktues i cenimit, të paktën në dukje, nuk është rezultat i drejtpërdrejtë dhe i lidhur ngushtë me procesin e gjykatave të zakonshme.

21. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione materiae* për një pjesë të pretendimeve të tyre. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në

aspektin e parimit të sigurisë juridike që lidhet me mospërmbushjen e pritshmërive të tyre për vlerësimin e pronës së njohur për kompensim, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, dhe për cenimin e së drejtës së pronës private, në aspektin e proporcionalitetit, të garantuar nga nenet 41 dhe 17 të saj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

22. Kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta për proces të rregullt në aspektin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, pasi vendimet përfundimtare administrative ose gjyqësore që përmbajnë një shumë të caktuar kompensimi për t'u dhënë, por që nuk janë zbatuar ende, nuk duhet të rivlerësohen. Sipas tyre, pritshmëritë e krijuara nga veprimtaria ndër vite e organeve përgjegjëse për kthimin dhe kompensimin e pronës për vlerësimin e pronës me zërin kadastral “tokë truall” nuk u përmbushën nga ATP-ja në vitin 2016, që e rivlerësoi atë me zërin kadastral “tokë bujqësore”.

23. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkuesit në thelb ankohen për masën e shpërblimit të kompensimit, i cili ndonëse nuk është i plotë, është i drejtë sipas jurisprudencës kushtetuese dhe asaj evropiane. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, ATP-ja, nuk ka shprehur qëndrim për këtë pretendim.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

25. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar lidhjen që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt, në të cilën ky parim përgjithësisht shfaqet në formën e gjësë së gjykuar. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu referuar standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se KKKP-ja në vitet 1994 dhe 1997, bazuar në ligjin e kohës për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ka njohur subjektit të shpronësuar të drejtën e pronësisë dhe të kompensimit për tokën e llojit “truall”. Në vitin 2015 AKKP-ja i ka kompensuar financiarisht trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar për sipërfaqen 200 m², duke e vlerësuar pronën me zërin kadastral “truall”. Duhet evidentuar se organet e pushtetit publik në dhënien e këtyre vendimeve janë bazuar në ligjin e kohës për kthimin dhe kompensimin e pronës subjekteve të shpronësuara, i cili parashikonte të drejtën e kompensimit pa referencë të zëri kadastral i pronës në kohën e shpronësimit.

27. Gjykata vëren se kërkuesit në procesin ligjor të zhvilluar nga ATP-ja dhe në vijim në procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat, që kanë vendosur për rivlerësimin financiar të pronës, kanë pritur që kompensimi i pjesës së mbetur të pasurisë të bëhej për pasurinë sipas të njëjtut zëri kadastral, atij të llojit “truall”. Ndërkohë, ATP-ja në vitin 2016 e ka rivlerësuar pasurinë duke e kategorizuar atë në zërin kadastral “tokë bujqësore”. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit, pas shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjes për vlerën e kompensimit, ka vlerësuar se ATP-ja ka zbatuar drejt kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 133/2015. Në vendimin e saj është interpretuar ligji i kohës së shpronësimit, duke arsyetuar se tokë bujqësore në atë kohë konsiderohej toka e punuar dhe se ligji agrar, në fuqi në atë kohë, përcaktimin e tokës bujqësore nuk e lidhte ngushtësisht me vendndodhjen brenda ose jashtë vijave kufizuese të qytetit. Po kështu, ajo gjykatë ka arsyetuar edhe për përmbajtjen e vërtetimit të pronësisë kadastrale të datës 9.8.1993, sipas të cilit zëri kadastral i origjinës së pronës së kërkuesve ishte “tokë bujqësore”. Cilësimi i pronës së kërkuesve në kategorinë “tokë bujqësore”

është vlerësuar i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se ky cilësim bazohet në legjislacionin e posaçëm të kohës së shpronësimit – ligji “Mbi reformën agrare”, datë 29.8.1945, dekreti “Mbi pronësinë” dhe dekreti “Mbi sistemin agrar të tokave dhe regjistrimin e tyre”. Sipas Gjykatës së Lartë legjislacioni i posaçëm në kohën e shpronësimit jepte kuptimin e konceptit “tokë e punuar” dhe përcaktimin e tokës si “tokë bujqësore” ose “truall” nuk e lidhte domosdoshmërisht me vendndodhjen e saj në raport me vijën kufizuese të qytetit.

28. Gjykata konstaton se e drejta e kompensimit të pronës së kërkuesve është përcaktuar në vitin 1994 në raport me sipërfaqen dhe llojin e pasurisë, por pa treguar vlerë financiare konkrete. Në vlerësimin financiar të vitit 2016, ATP-ja ka ndryshuar kategorizimin e pronës së njohur për kompensim në krahasim me kategorizimin e pjesëve të pronës që iu ishte kthyer dhe kompensuar financiarisht më parë, si pasojë e të cilit vlera ka rezultuar në masë më të ulët se sa ata pretendonin. Megjithatë, rikategorizimi i pronës ka ardhur si pasojë e skemës së re të kompensimit, të miratuar me ligjin nr. 133/2015, i cili ndryshoi sistemin e referencës për kategoritë e pronave në atë të kohës së shpronësimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në thelb, lidhet me përmbajtjen e ndryshimeve ligjore, pasi ATP-ja në vitin 2016 kur ka rivlerësuar pronën e kërkuesve me zërin kadastral “tokë bujqësore” nuk bëri gjë tjetër veçse zbatoi skemën e re të rivlerësimit të përcaktuar nga ligji nr. 133/2015.

29. Gjykata ka pohuar se parimi i sigurisë juridike, në rastin e ndryshimeve ligjore, nuk mund të prevalojë në çdo rast. Nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke u bazuar edhe te ky standard, skema e re e rivlerësimit të pronës, e miratuar me ligjin nr. 133/2015, e ka kaluar testin e kushtetutshmërisë në drejtim të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*), nëse rezultati konkret i rivlerësimit respekton pragun 10 % (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të ndryshimit të zërit kadastral të pronës, si pasojë e veprimtarisë së organeve përgjegjëse për kthimin dhe kompensimin e pronës, është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së pronës private në drejtim të parimit të proporcionalitetit

31. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë, duke mos e prishur vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, nuk ka respektuar praktikën e GJEDNJ-së, në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, ku ajo e ka konsideruar të arsyeshëm minimumin e vlerësimit të pasurisë në masën 10% të vlerës së tregut. Sipas tyre, masa e kompensimit financiar, e cila nuk është as në vlerën minimale të konsideruar nga vetë GJEDNJ-ja përbën ndërhyrje në mënyrë jo proporcionale në të drejtën e pronës.

32. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se ky pretendim vjen në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme kushtetuese dhe atë evropiane që ka trajtuar çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave referuar rastit të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 4, datë 15.2.2021 ka mbajtur qëndrimin se në rastin e subjekteve të shpronësuar, shpërblimi duhet të jetë i drejtë, edhe nëse nuk është i plotë. Në këtë kuptim, ligji nr. 133/2015, i cili ka ndryshuar skemën e kompensimit duke iu referuar zërit kadastral në kohën e shpronësimit, synon përfundimin e këtij procesi në një mënyrë të drejtë. GJEDNJ-ja, në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendimi i datës 17.3.2020, ka konfirmuar procesin sipas skemës së ligjit nr. 133/2015 dhe i vetmi korrigjim lidhet me miratimin e një tavani 10% për diferencën mes vlerësimit sipas zërit kadastral të sotëm dhe zërit kadastral të kohës së shpronësimit. Në këtë situatë, është gjetur një mekanizëm, i cili kënaq interesat e subjekteve të shpronësuar, si dhe ruan balancat ekonomike dhe financiare të shtetit.

33. Subjekti tjetër i interesuar, ATP-ja, në prapësimet me shkrim ka paraqitur llogaritjet e bëra për shkak të të cilave subjekti i shpronësuar konsiderohej i kompensuar. Kështu, sipas ATP-së, vlerësimi i pronës së kthyer me vendimet e KKKP-së, Bashkia Tiranë, në emër të subjektit të shpronësuar në vlerën 161,723,034 lekë, është më i madh se sa vlerësimi i tokës së njohur për kompensim në vlerën 2,188,840 lekë.

34. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (pika 1), duke parashikuar, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm për interesa publikë (pika 3) dhe se kufizimet lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (pika 4), për masën e të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (pika 5).

35. Gjykata ka theksuar se kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të Kushtetutës, konform edhe nenit 181 të saj. Gjithashtu, Gjykata e ka interpretuar shpërblimin e drejtë lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Në drejtim të hapësirës së ligjvënësit për të rregulluar çështjen e kompensimit të pronave të shtetëzuara ose konfiskuara gjatë regjimit komunist, Gjykata ka pohuar se e drejta e pronës nuk njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Nga kriteret kushtetuese të “rregullimit të drejtë” dhe të “shpërblimit të drejtë”, të pranuar në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës, rezulton se kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata evidenton se përgjatë periudhës 2017–2021 ajo ka shqyrtuar dy herë pajtueshmërinë me Kushtetutën të parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, që lidheshin me vlerën e kompensimit të pronave, duke u shprehur me vendimet përfundimtare nr. 1, datë 16.1.2017 dhe nr. 4, datë 15.2.2021.

37. Fillimisht, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015, pasi cenonin sigurinë juridike dhe, si të tilla, nuk ishin në pajtim me Kushtetutën, me arsyetimin se këto dy pika, sipas përmbajtjes së tyre, të çonin në përfundimin se ato janë konceptuar si një shpronësim i ri, duke qenë se parashikojnë rivlerësimin e pronave të kthyera ose të kompensuara më parë. Për sa i takon skemën së rivlerësimit për pronat e tjera, Gjykata është shprehur se metodologjia dhe formula e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 ndërhyjnë në të drejtën e pronës private të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, por kjo ndërhyrje respekton elementet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Skema e re e kompensimit, e miratuar në ligjin nr. 133/2015, ka ndryshuar metodën e vlerësimit dhe elementi kryesor i vlerësimit të kompensimit financiar është vlera e pronës sipas zërit kadastral që ajo ka pasur në kohën e shpronësimit. Kjo metodë është e ndryshme nga legjislacioni i mëparshëm dhe mund të rezultojë në masë kompensimi më të ulët se sa ajo e parashikuar nga ligjet e mëparshme, të cilat kishin krijuar pritshmëri për marrjen e kompensimeve sipas vlerës së tregut të pronës në momentin e nxjerrjes së vendimit për kompensimin. Ndonëse masa më e ulët e kompensimit nuk mund të cilësohet si shpronësim formal, ajo mund të cilësohet fare mirë si një “ndërhyrje tjetër”, e cila, pavarësisht se mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuara, në tërësinë e saj respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës së tyre dhe, si e tillë, është në respektim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

38. Pas vlerësimit të parë nga Gjykata, dispozitat e ligjit nr. 133/2015 janë analizuar edhe nga GJEDNJ-ja, sipas së cilës, në rastet kur vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit të dhënë më parë janë pa vlerë të përcaktuar, me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit,

pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar. Pragu minimal 10% për vlerën e kompensimit mund të konsiderohet i arsyeshëm në kontekstin specifik të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri, për shkak të nivelit të përgjithshëm sakrifikues që skema e re e kompensimit imponon te subjektet e shpronësuar, krahasuar me pritshmërinë e tyre për të marrë kompensim me vlerën e tanishme të tregut që buronte nga legjislacioni i mëparshëm (*shih vendimin Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.3.2020, §196*).

39. Në vijim, në datën 24.12.2020, Këshilli i Ministrave ndryshoi vendimin nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar (VKM nr. 223/2016) duke parashikuar, ndër të tjera, kompensimin në masën 10% të llogaritur sipas zërit aktual kadastral të pronës.

40. Më pas, Gjykata dha vendimin e saj të dytë nr. 4, datë 15.2.2021 për kontrollin kushtetues të ligjit nr. 133/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në të cilin është shprehur se edhe pse VKM-ja nr. 223/2016 përmirësonte shpërblimin e subjekteve në krahasim me ligjin, këto lloj parashikimesh jo vetëm në kuptim të rezervës ligjore absolute, por edhe të parimit të sigurisë juridike, janë çështje që i takojnë kompetencës ekskluzive të ligjvënësit. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e pronës private kufizohet si pasojë e mungesës së rregullimit nga pika 2 e nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 të situatës së ndryshimit që ka pësuar zëri kadastral i pronës ndër vite. Kjo mungesë rregullimi përbënte boshllëk ligjor, nga i cili vinin pasoja negative për të drejtat kushtetuese të individëve, në rastin konkret e drejta e pronës private. Kjo mungesë e rregullimit ligjor të situatës që ka rezultuar nga ndryshimi i zërit kadastral, i ka mohuar kompensimin e drejtë kësaj kategorie subjektsh. Për rrjedhojë, Gjykata i la detyrë Kuvendit të plotësonte ligjin nr. 133/2015 brenda afatit 6-mujor, duke filluar ky afat nga data 8.3.2021, por deri në kohën e marrjes së këtij vendimi nuk rezulton të jetë përmbushur ky detyrim. Sipas Gjykatës, pragu i rekomanduar nga GJEDNJ-ja prej 10% të vlerës që duhet përfituar, nëse do të përdorej si referencë zëri kadastral aktual i pronës së shpronësuar, përbën minimumin e garancive që duhet të sigurohen, por nuk e pengon ligjvënësin të bëjë rregullimet e nevojshme brenda hapësirës së tij të vlerësimit dhe në përputhje me kërkesat e nenit 41 të Kushtetutës dhe faktorë të tjerë socialë, ekonomikë e politikë që ndikojnë në vendimarrjen e tij.

41. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se subjektit të shpronësuar i është njohur për efekt të kompensimit financiar, fillimisht në vitin 1994, trualli me sipërfaqe 19.122 m² dhe pas ndryshimeve në vitin 1997 (për shkak të zbritjeve të kompensimit nga obligacionet shtetërore të llogaritura në masën 817 m²), i mbetej për t’u kompensuar trualli me sipërfaqe 18.305 m². Në këto vendime është përcaktuar e drejta e kompensimit dhe sipërfaqja e pasurisë, por jo vlera konkrete e kompensimit. Ndërkohë, me vendimin nr. 103, datë 30.4.2015 të AKKP-së trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar janë kompensuar financiarisht për sipërfaqen 200 m² në vlerën 6.011.800 lekë, duke e llogaritur atë në masën 30.059 lekë/m². Si përfundim, ata kanë fituar të drejtën e kompensimit për sipërfaqen prej 18.105 m².

42. Gjykata konstaton se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, në thelb, është ngritur pretendimi kushtetues për shpërblimin e drejtë të pronës. Në përmbajtje të pretendimit është parashtruar se ndonëse vite më parë autoritetet shtetërore u kishin njohur të drejtën e kompensimit, në vitin 2016 ATP-ja dhe në vijim Gjykata Administrative e Apelit janë shprehur se kompensimi konsiderohej i ezauruar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-188, datë 10.2.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte në përputhje me ligjin.

43. Gjykata konstaton se në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë janë referuar vendimi nr. 1, datë 16.1.2017 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi i GJEDNJ-së për çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 31.7.2012, por nuk përmenden dhe nuk analizohen vendimi nr. 4, datë 15.2.2021 i Gjykatës Kushtetuese, që ka hyrë në fuqi në datën 12.9.2021 dhe i GJEDNJ-së për çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 17.3.2020, njoftuar me shkrim më 7.5.2020. Këto dy vendimmarrje të fundit, të cilat janë marrë dhe kanë hyrë në fuqi përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, kanë sjellë ndryshime me rëndësi për të drejtën e pronës private, duke përcaktuar standardin minimal 10 % të vlerës aktuale të saj. Ndërkohë, mbi pyetjet e Gjykatës në seancë plenare, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, duke theksuar se ligji nr. 133/2015 vazhdon të kishte boshllëk ligjor të paplotësuar nga Kuvendi, paraqiti përlllogaritjet e ATP-së me shkrim. Sipas këtyre përlllogaritjeve, nëse në rastin e kërkesve zbatohet standardi 10 % i vlerës së zërit kadastral aktual, atëherë rezultati i rivlerësimit të pronës së tyre do të ishte i ndryshëm, pra jo i ezauruar, edhe pse në kohën e shpronësimit zëri kadastral i pronës ishte “tokë bujqësore”.

44. Gjykata thekson se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 10, datë 4.3.2021, nr. 49, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Po ashtu, Gjykata thekson detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare mbështetur në nenin 5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në përmbledhje të rrethanave të konstatuara, në rastin e kërkesve, nuk është analizuar nëse vlerësimi i pronës ka respektuar standardin minimal “10 % për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit”, në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, pasi në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk janë marrë në konsideratë vendimet detyruese të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Kjo situatë është rrjedhojë e disa faktorëve, duke filluar me mosveprimin e Kuvendit për plotësimin e detyrimit të caktuar me vendimin nr. 4, datë 15.2.2021 të kësaj Gjykate, me ekzistencën për një kohë të konsiderueshme të boshllëkut ligjor, me mosrespektimin e fuqisë detyruese të jurisprudencës kushtetuese dhe ndërkombëtare, për të përfunduar me arsyetimin e gjykatave, të cilat, në çdo rast, duhet të luajnë rolin e tyre subsidiar për respektimin e të drejtave themelore, pa u shmangur nga ky rol edhe në rastet e boshllëkut ligjor.

47. Gjykata evidenton se mënyra e duhur për rivendosjen e së drejtës së kërkesve është shqyrtimi nga gjykatat e zakonshme nëse vlerësimi i pronës së kompensuar kërkesve respekton standardin e pragut 10% sipas vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së. Gjykata, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, rithekson rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës së Lartë, së cilës i përket detyra kushtetuese për të siguruar njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Pavarësisht boshllëkut në legjislacion, ajo gjykatë nuk ka asnjë pengesë të zgjidhë vetë çështjen bazuar në parimet e vlerësimit të përcaktuara tashmë, duke i zbatuar drejtpërsëdrejti vendimet e sipërcituara, ose të orientojë zgjidhjen e saj nga

gjykata më e ulët, duke njësuar dhe zhvilluar edhe praktikën gjyqësore në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato të GJEDNJ-së.

48. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës së pronës private, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj kërkesa e tyre duhet pranuar¹.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-188, datë 10.2.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë saj.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 14.11.2022.

Shpallur, më 15.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska

¹ Gjyqtarja Elsa Toska votoi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës, me qëllim që t’i jepej fillimisht mundësia Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, për të konkluduar për cenimin ose jo të së drejtës së pronës në kuptimin material, në analizë të zbatimit të vendimit nr. 4, datë 15.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese dhe të vendimit të GJEDNJ-së për çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 17.3.2020.